



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Shërbime Publike,
Administratë Lokale dhe Media
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës.
14.03.2008, ora: 14:00, N-10

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Esat Brajshori, Fehmi Mujota, Shpresa Murati, Gani Buqinca, Hajdin Abazi, Anita Morina, Rasim Selmanaj, Radmila Vujovic, Synavere Rysha, ndërsa munguan : Melihate Tërmkolli, Ali Lajçi.

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Drita Morina, Lule Ymeri në cilësinë e zyrtareve ligjore dhe Mirjeta Heta, asistente administrative.

Mbledhjen e udhëhoqi Esat Brajshori, kryetar i Komisionit, me këtë:

Rend dite:

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
- 2. Rishqyrtimi i shkresës së TV- Mitrovica.**
- 3. Shqyrtimi i raportit vjetor të KPM-së, 2007.**
- 4. Shqyrtimi i planit të punës së komisionit për vitin 2008.**
- 5. Të ndryshme.**

Esat Brajshori - propozoi që nga rendi i ditës të hiqet pika e tretë, pas njoftimit që kishte marrë nga zyra e shefit ekzekutiv të KPM-së, se në mbledhje nuk do të marrë pjesë zëvendës - kryesuesja e këshillit të KPM-së, e cila me ftesë të komisionit ishte e ftuar të marrë pjesë.

Rendi i ditës u miratua nga komisioni me ndryshimin që pika e tretë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës, me arsyen e lartpërmendur.

Pika e parë e rendit të ditës -

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

Pika e dytë e rendit të ditës – filloi me propozimet e anëtarëve të komisionit për TV-Mitrovicën –

Gani Buqinca – tha se, në bazë të fakteve që palët i kanë prezantuar, KPM-ja ka arbitraritet dhe subjektivizëm në praktikën e punës së saj. Ai, rekomandoi që urgjentisht TV- Mitrovicës duhet t'i kthehen pajisjet e konfiskuara, licenca e punës dhe kompensimi i dëmeve të shkaktuara nga KPM-ja e pastaj të fillohet me përpjekjet që TV- Mitrovica të veprojë në pajtueshmëri me licencën.

Rasim Selmanaj - tha se KPM-ja duhet ta zbatojë ligjin njësoj e jo në mënyrë selektive ai propozoi që TV - Mitrovicës ti kthehen pajisjet e konfiskuara dhe licenca e punës.

Anita Morina - propozoi që TV- Mitrovicës t'i kthehen pajisjet e konfiskuara dhe licenca e punës ngase kjo është e domosdoshme dhe në interes të popullatës së Mitrovicës e cila në këtë situatë në mungesë të transmetuesit nuk po informohet drejt.

Hajdin Abazi – tha se vendimi për TV- Mitrovicën është vendim përjashtues, duke konsideruar si pozitive propozimet e anëtarëve të komisionit, ai ndau mendimin me diskutuesit e mëparshëm.

Radmila Vujovic - duke konfirmuar se ka mendim të njëjtë me anëtarët e Komisionit dhe se me vëmendje ka përcjellur problemin e TV- Mitrovicës ajo propozoi,që TV-Mitrovicës t'i kthehet licenca.

Fehmi Mujota - propozoi që komisioni t'i drejtohet KPM-së me rekomandim për rishqyrtimin e vendimit.

Esat Brajshori - tha se zbatimi selektiv i ligjit nënkupton shkelje ligjore.

Pas propozimeve të anëtarëve të komisionit, komisioni unanimitisht vendosi që KPM-së ti drejtohet me shkresë, si vijon:

Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, i propozon KPM-së që ta rishqyrtojë vendimin për mbylljen e TV-Mitrovicës.

Arsyetim

Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media vlerëson se Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit në fuqi, duke zbatuar standarde të dyfishta ka aplikuar ligjin në mënyrë selektive.

Gjithashtu, Komisioni vlerëson se delegimi i kompetencave tek Zyra e Shefit Ekzekutiv është në kundërshtim me ligjin.Vendimi - njoftimi për shkelje të datës 24.12.2007 në

bazë të së cilit, Zyra e Shefit Ekzekutiv ka ekzekutuar urdhrin për mbylljen e TV-Mitrovicës dhe ka konfiskuar pajisjet, është arbitrar dhe subjektiv.

Sipas komisionit, Këshilli nuk ka vlerësuar faktet që i ka ofruar TV-Mitrovica për sjelljen e antenave në pajtueshmëri me licencën, nuk ka ballafaquar ekspertizat e ekspertëve të cilët në raportet e tyre vlerësuese kanë konstatuar se pasaktësia e sistemit të antenave mund të korrigjohej dhe tejkalimi i mbulueshmërisë sipas licencës është i arritshëm, në bazë të vendimit të Bordit të Mediave për Ankesa, të datës 27.11.2006.

Komisioni nuk e mohon faktin se TV-Mitrovica ka bërë tejkalim të licencës, duke shtrirë mbulueshmëri më të gjerë sesa është përcaktuar me licencë, por sipas dëshmive të ofruara, kjo ka ndodhë për shkak të konfiguracionit të terrenit, pasi që në Cernushë aty ku është e vendosur antena e TV – Mitrovicës, është e vendosur edhe antena e ish – RTP-së e KTTN-së, shtylla e UNHCR, e UNMIK-ut dhe antena e IPKO-s, - kabllorë ilegal.

Pika e katërt e rendit të ditës – Komisioni shqyrtoi draft planin e punës për vitin 2008 bazuar në strategjinë legjislative të Qeverisë dhe të njëjtin e miratoi.

Gjithashtu komisioni konstatoi se plani i punës së komisionit mund të ndryshohet dhe plotësohet, konform strategjisë legjislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kryetari i Komisionit:

Esat Brajshori